



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.9380/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12 paragrafi 2 shkronja d, 14, 40, Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005 neni 9, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 25, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.11.2022 merr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE TË TATIMIT PËR PRONAT REZIDENCIALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2023

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për caktimin e normave tatimore për të gjitha kategoritë e pronave rezidenciale, të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2023.
2. Normat tatimore vendosen brenda kufijve të përcaktuar si më poshtë dhe janë të vlefshme nga fillimi i vitit tatimor 2023:

Nr.	Kategoria e pronës	Norma tatimore
1	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
2	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Tatimit në Pronë.
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Tatimit në Pronë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:24.11.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta